

PROGRAM TRAJNIMI

“AFTËSI PËR PUNËSIM”

TIRANË, 2024

HYRJE

Në një treg pune që po transformohet me shpejtësi, shumë individë përballen me sfida për të siguruar një punë të qëndrueshme, shpesh për shkak të mungesës së aftësive bazë dhe të punëkërimit.

Për ata që nuk kanë përvojë ose nuk janë të arsimuar, rruga drejt punësimit duhet të paraprihet nga një mbështetje për zhvillim personal dhe profesional, për t'u përballur me sfidat e tregut të punës dhe për të arritur suksesin e dëshiruar.

Ekziston një gamë e gjerë aftësish, të cilat janë thelbësore, për të funksionuar me sukses në jetë dhe punë. Përveç "aftësive të shekullit XXI", punësimi i qëndrueshëm kërkon edhe njohuri financiare dhe aftësi të gjelbra.

I. QËLLIMI I TRAJNIMIT “AFTËSI PËR PUNËSIM”

Qëllimi kryesor i trajnimit “Aftësi për punësim” është zhvillimi i aftësive thelbësore sociale, kompetencave digjitale dhe aftësive për kërkimin dhe aplikimin për punë, për kategori të ndryshme të personave të papunë, duke përfshirë ata që përfitojnë ndihmë ekonomike (15-29 vjeç) dhe që ende nuk janë integruar në tregun e punës.

Për të realizuar këtë, ofruesit e AFP-së do t'u krijojnë pjesëmarrësve:

- mundësi për të nxënë, pavarësisht gjinisë, racës, besimit dhe aftësive;
- mundësi që të zhvillojnë kompetencat e parashikuara, të bazuara në njohuri, shprehi, qëndrime dhe vlera, të mjaftueshme për të lehtësuar përparimin drejt punësimit, formimit profesional apo arsimit;
- mundësi për të zhvilluar disiplinën, frymën e tolerancës dhe mirëbesimit, si dhe aftësitë për njohjen e vetes dhe vendimmarrjen, përfshirë vlerat morale;
- mundësi të vlerësimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të mbështetjes për përshtatje;
- mundësi për mbështetje psikologjike dhe përballje me vështirësitë që mund të ndeshin në rrugën drejt integritetit profesional.

Trajnimi është fokusuar në zhvillimin e një grupi aftësish thelbësore dhe nxit pjesëmarrësit që t'i përmirësojnë më tej këto aftësi ose të zhvillojnë aftësi të tjera bazuar në nevojat dhe mundësitë e tyre. Trajnimi do të shoqërohet me mbështetje psiko-sociale të pjesëmarrësve, si dhe orientim për karrierën.

II. KRITERET PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIM

Në këtë trajnim mund të marrin pjesë persona që:

- përfitojnë ndihmë ekonomike;
- janë të papunë;
- janë mbi 15 vjeç;

Rekomandohet përfundimi i të paktën arsimit fillor.

III. KOMPETENCAT E FITUARA NGA PJESËMARRËSIT NË PËRFUNDIM TË TRAJNIMIT

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë të aftë:

- të komunikojnë në situata reale;
- të bashkëpunojnë në grup dhe të menaxhojnë konfliktin;
- të sillen me etikë personale dhe profesionale në punë;
- të përshkruajnë aftësitë e gjelbra në jetën e përditshme dhe t'i zbatojnë ato;
- të përdorin dokumentacionin personal;
- të aplikojnë për dokumentacionin personal në e-Albania;
- të përdorin platformën e AKPA-s për të kërkuar dhe aplikuar për punë;
- të kryejnë veprime të thjeshta me paranë;
- të vlerësojnë aftësitë, dëshirat, nevojat dhe sfidat, si dhe të planifikojnë dhe të marrin vendim për punësim/formim profesional/arsim;
- të kërkojnë punë nëpërmjet kanaleve të ndryshme të kërkimit;
- të përdorin mjetet e komunikimit digjital për të kërkuar dhe aplikuar për punë;
- të përshkruajnë funksionet e kompjuterit, që do t'iu shërbejnë në jetë dhe punë;
- të hartojnë një dokument të thjeshtë në Word;
- të përdorin email-in personal;
- të hartojnë CV-në dhe letrën e motivimit;
- të njohin elemente të sigurisë në jetë dhe punë.

IV. MUNDËSITË PËR PUNËSIM/FORMIM PROFESIONAL/ARSIM

Në përfundim të këtij trajnimi, çdo pjesëmarrës, duke u bazuar në vlerësimin e aftësive personale, ka mundësinë:

- të integrohet në tregun e punës, duke kërkuar punë në fushat që përputhen me interesat dhe aftësitë e tij/saj;
- të ndjekë kurse për formim profesional, duke zhvilluar më tej aftësitë dhe kompetencat e nevojshme në një fushë specifike;
- të vazhdojë arsimimin e detyruar me kohë të pjesshme, duke gjetur një ekuilibër midis arsimimit dhe angazhimeve të tjera personale apo profesionale.

V. KOHËZGJATJA E TRAJNIMIT

Institucioni ofrues i AFP-së mund të organizojë trajnimin në varësi të kushteve dhe specifikave të grupeve. Trajnimi do të ketë kohëzgjatje të caktuar:

- 60 orë mësimore;
- 1 orë mësimore = 45 minuta;
- Rekomandohet të zhvillohen 3- 4 orë mësimore në ditë.

VI. PROGRAMI MODULAR I TRAJNIMIT “AFTËSI PËR PUNËSIM”

Nr.	Titulli i modulit	Kohëzgjatja	Rezultatet e të nxënit
1	Aftësi të komunikimit dhe etikës	12 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi komunikon në situata reale; - Pjesëmarrësi bashkëpunon në grup dhe menaxhon konfliktin; - Pjesëmarrësi analizon parimet bazë të etikës; - Pjesëmarrësi zbaton rregullat e etikës personale dhe profesionale në punë.
2	Aftësi të thjeshta financiare	4 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi kryen veprime të thjeshta me paranë; - Pjesëmarrësi ndërton një buxhet të thjeshtë të shpenzimeve në bazë të të ardhurave; - Pjesëmarrësi demonstroi sesi hapet një llogari të thjeshtë bankare.
3	Aftësi digjitale	8 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi përshkruan pjesët e kompjuterit; - Pjesëmarrësi përdor kompjuterin dhe internetin;
4	Aftësi të gjelbra për punë të gjelbra	4 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi përshkruan aftësitë “e gjelbra” dhe i zbaton ato; - Pjesëmarrësi shpjegon lidhjen e aftësive e gjelbra me mundësitë për punësim.
5	Njohja e vetvetes dhe vendimmarrja	8 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi kryen vetëvlerësimin; - Pjesëmarrësi merr vendime për karrierën e tij.

6	Dokumentacioni personal dhe kontrata e punës	8 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi përshkruan dokumentet kryesore personale; - Pjesëmarrësi përdor platformën e-Albania për të siguruar dokumentacionin personal; - Pjesëmarrësi shkruan CV-në me shkrim dhe kompjuter; - Pjesëmarrësi shkruan letrën e motivimit me shkrim dhe kompjuter; - Pjesëmarrësi përshkruan elementet e kontratës së punës;
7	Aftësi për të kërkuar punë	12 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi kërkon punë nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë; - Pjesëmarrësi kërkon punë nëpërmjet internetit; - Pjesëmarrësi përdor platformën e-Albania; - Pjesëmarrësi përdor platformën e AKPA-s për kërkimin e punës; - Pjesëmarrësi demonstroi sjelljet përpara, gjatë dhe pas intervistës së punës.
8	Rregullat e sigurisë në jetën e përditshme dhe në punë	4 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	- Pjesëmarrësi përshkruan sigurinë në jetën e përditshme; - Pjesëmarrësi përshkruan sigurinë në vendin e punës.

VII. UDHËZIME PËR PROCESIN E TRAJNIMIT

Trajnerët duhet të **përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje**, që nxisin pjesëmarrjen dhe të nxënit aktiv të pjesëmarrësve, **duke synuar zhvillimin e kompetencave të plota dhe të qëndrueshme**.

Planifikimi i mësimdhënies duhet të bazohet në një analizë fillestare, që merr parasysh faktorë të rëndësishëm, si mosha e pjesëmarrësve, përvoja e tyre jetësore dhe profesionale, niveli arsimor, përmbajtja e moduleve dhe shkalla e integritit të tyre, si dhe mundësitë reale të pjesëmarrësit. Ky planifikim kërkon një bashkëpunim të ngushtë mes gjithë stafit të trajnimit dhe drejtuesve të institucionit të AFP-së.

Një element kyç për suksesin e trajnimit është **motivimi i pjesëmarrësve**. Trajnuesit duhet të përdorin metoda që zhvillojnë aftësitë, shprehjet dhe qëndrimet e pjesëmarrësve lidhur me komunikimin, vendimmarrjen, menaxhimin e parave, përdorimin e kompjuterit e platformave digjitale për punëkërkim dhe shkrimin e dokumenteve të nevojshme për sigurimin e një interviste pune.

Puna në grup dhe komunikimi janë themeli për të zhvilluar kompetencat kyçe të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që lidhen me të ardhmen profesionale dhe karrierën.

VIII. UDHËZIME PËR VLERËSIMIN DHE CERTIFIKIMIN

Qëllimi kryesor i vlerësimit është të matet përparimi dhe arritja e pjesëmarrësve në përvetësimin e aftësive dhe kompetencave gjatë trajnimit. **Vlerësimi gjithashtu ndihmon në identifikimin e fushave ku pjesëmarrësit kanë nevojë për mbështetje shtesë dhe zhvillim të mëtejshëm.**

Në përfundim të trajnimit, pjesëmarrësit do të marrin “Certifikatë pjesëmarrjeje”, e cila dëshmon përvetësimin e aftësive të zhvilluara gjatë trajnimit. Ajo do të shoqërohet me një përshkrim të aftësive dhe kompetencave që kanë përfituar pjesëmarrësit, sipas kriterëve të mëposhtme.

Certifikata do të jetë e njohur nga AKPA dhe partnerët e tjerë bashkëpunues. Përshkrimi i aftësive dhe kompetencave që kanë përfituar pjesëmarrësit do të reflektohet në planin individual të punësimit nga zyra e punësimit.

Kriteret e vlerësimit	Shpjegimi
1. Frekuentimi	Sa shpesh ka marrë pjesë në trajnim?
2. Pjesëmarrje aktive/motivimi	A merr pjesë në diskutime, ushtrime dhe aktivitete?
3. Vetëkontrolli emocional	A tregon pjesëmarrësi vetëkontroll në menaxhimin e emocioneve të tij dhe ndërveprimin me të tjerët?
4. Komunikimi efektiv	Sa mirë komunikon pjesëmarrësi me instruktorin e trajnimit dhe pjesëmarrësit e tjerë?
5. Bashkëveprimi	A bashkëpunon pjesëmarrësi në mënyrë efektive në aktivitetet dhe detyrat në grup?
6. Përballimi i vështirësive	Si reagon pjesëmarrësi kur përballlet me sfida ose vështirësi në procesin e të mësuarit?
7. Aplikimi i aftësive të reja	A është në gjendje pjesëmarrësi të aplikojë njohuritë dhe aftësitë e marra gjatë trajnimit në situata reale?
8. Vlerësimi i vetvetes	A është pjesëmarrësi i aftë të reflektojë mbi pikat e forta dhe nevojat për përmirësim gjatë trajnimit dhe të zhvillojë një plan përmirësimi?

PËRSHKRUESIT E MODULEVE

1. MODULI “AFTËSI TË KOMUNIKIMIT DHE ETIKËS”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Aftësi të komunikimit dhe etikës	
Qëllimi i modulit	Moduli i njeh pjesëmarrësit me aftësitë bazë të komunikimit dhe etikës dhe i aftëson ata të përdorin sipas nevojës llojet e ndryshme të komunikimit, të etikës, në situata të ndryshme të jetës reale dhe në tregun e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	12 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi komunikon në situata reale. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë format e komunikimit verbal dhe joverbal; - të demonstrojë në kontekste reale formatet dhe teknikat e komunikimit verbal dhe joverbal; - të demonstrojë aftësi për të shprehur pikëpamjet brenda një grupi. - të përshkruajë format e komunikimit përmes shenjave grafike; - të përshkruajë shenjat grafike për lëvizshmëri, si konsumator, në vendin e punës etj.
	RN 2	Pjesëmarrësi bashkëpunon në grup dhe menaxhon konfliktin. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet: - të përshkruajë rëndësinë e bashkëpunimit në grup; - të përshtatet në sipas situatave të ndryshme; - të zgjidhë problemet; - të menaxhojë dhe organizojë kohën; - të ndërtojë marrëdhënie; - të tregojë mirëkuptim dhe respekt për tjetrin; - të shfaqë qëndrime dhe besime konstruktive.
	RN 3	Pjesëmarrësi zbaton parimet bazë të etikës. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë situata etike në jetën personale; - të analizojë pasojat etike të vendimeve që merr; - të zgjidhë dilemat etike që mund të ndeshë; - të reflektojë mbi sjelljet e tij.

	RN 4	Pjesëmarrësi zbaton rregullat e etikës personale dhe profesionale në punë. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë situata etike në vendin e punës; - të zgjidhë dilemat etike që mund të ndeshë; - të përshkruajë konceptin e profesionalizmit në punë; - të përshkruajë konceptin e reputacionit të mirë në punë; - të demonstrojë elemente të disiplinës personale; - të përshkruajë pasojat e shpërqendrimit dhe minimizimin e tij gjatë punës; - të përshkruajë ruajtjen e ekuilibrit mes punës dhe jetës personale.
--	-------------	--

2. MODULI “AFTËSI TË THJESHTA FINANCIARE”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Aftësi të thjeshta financiare	
Qëllimi i modulit	Moduli synon njohjen e monedhave dhe kartëmonedhave dhe aftësimin në përdorimin e tyre në situata të improvizuara blerjeje dhe shitjeje. Gjithashtu, pjesëmarrësi aftësohet të ndërtojë një buxhet të thjeshtë të të ardhurave dhe shpenzimeve.	
Kohëzgjatja e modulit	4 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi kryen veprime të thjeshta me paranë. <i>Kriteret e vlerësimit</i> Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë llojet e monedhave e kartëmonedhave dhe vlerën e tyre; - të kryejë veprime shkëmbimi me monedha dhe kartëmonedha nga 5-100 lekë, 100-500 lekë, 500-2000 lekë etj.; - të kryejë rolin e blerësit dhe shitësit duke përdorur paratë; - të marrë vendim për blerje në varësi të buxhetit; - të shpjegojë kursin e këmbimit dhe “çiftet” e monedhave (p.sh. Lek/Euro) - të demonstrojë shkëmbimin e shumave të vogla, duke përdorur normat aktuale të këmbimit.

	RN 2	Pjesëmarrësi ndërton një buxhet të thjeshtë të shpenzimeve në bazë të të ardhurave. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë se cilat janë të ardhurat; - të identifikojë se cilat janë të shpenzimet; - të ndërtojë një tabelë me dy kolona: të ardhurat dhe shpenzimet; - të kryejë llogaritje të thjeshta lidhur me kursimet personale.
	RN 3	Pjesëmarrësi demonstroi sesi hapet një llogari të thjeshtë bankare. Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë se çfarë është banka dhe shërbimet e saj; - të përshkruajë llogarinë bankare dhe se për çfarë shërben ajo; - të listojë dokumentet që i nevojiten për hapjen e llogarisë bankare; - të plotësojë një model formulari aplikimi të thjeshtë.

3. MODULI “AFTËSI DIGJITALE”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Aftësi digjitale	
Qëllimi i modulit	Moduli synon njohjen e pjesëmarrësve me funksionet e kompjuterit, përdorimin e tij, lidhjen me internet, dhe aftësimin e tyre për përdorimin e tyre në situata të jetës së përditshme dhe në vendin e punës.	
Kohëzgjatja e modulit	8 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi përshkruan pjesët e kompjuterit. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë pjesët kryesore të kompjuterit (ekrani, njësia qendrore, tastiera, mausi, programet kompjuterike); - të përshkruajë pajisjet që lidhen me kompjuterin (printerit, bokset etj.); - të hapë dhe mbyllë kompjuterin dhe programet, duke përdorur mausin dhe tastierën.

	RN 2	Pjesëmarrësi përdor kompjuterin dhe internetin. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përdorë programin Word; - të dallojë ikonën e dokumentit dhe dosjes (folder); - të përshkruajë lidhjen e kompjuterit me internetin; - të krijojë një llogari/të krijojë adresën e vet të email-it; - të përshkruajë përfitimet e përdorimit të internetit dhe email-it në jetën e përditshme dhe për të kërkuar punë.
--	-------------	--

4. MODULI “AFTËSI TË GJELBRA PËR PUNË TË GJELBRA”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Aftësi të gjelbra	
Qëllimi i modulit	Moduli synon njohjen e pjesëmarrësve me aftësitë e gjelbra, zbatimin e tyre në jetën personale dhe në punë, aftësimin për t’u orientuar në punë të gjelbra për të kontribuar në qëndrueshmërinë e mjedisit, si dhe për t’u përballur me sfidat e	
Kohëzgjatja e modulit	4 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi përshkruan aftësitë “e gjelbra” dhe i zbaton ato. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë aftësitë e gjelbra gjatë veprimtarive të jetës së përditshme dhe në vendin e punës; - të përshkruajë rëndësinë e aftësive të gjelbra në ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës etj. - të shpjegojë rëndësinë e përdorimit të biçikletave dhe transportit publik në vend të makinave me karburant për ruajtjen e mjedisit dhe përmirësimin të jetesës; - të përshkruajë rëndësinë e praktikimit të veprimeve të jetës së përditshme, sesi përdorimi i trashave prej lecke për pazare në vend të qeseve plastike, kursimi i ujit dhe energjisë elektrike në shtëpi dhe në vendin e punës, etj., ndikojnë pozitivisht në ruajtjen e mjedisit; - të përshkruajë rëndësinë e riciklimit në minimizimin e mbetjeve që shkojnë në vendet e grumbullimit të plehrave; - të ripërdorë produkte për të krijuar produkte të tjera.

	RN 2	Pjesëmarrësi shpjegon lidhjen e aftësive e gjelbra me mundësitë për punësim. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet jetë i aftë: - të tregojë profesione që kërkojnë njohje dhe praktikim të aftësive të gjelbra; - të përshkruajë rëndësinë e aftësive të gjelbra në krijimin e punësimeve të qëndrueshme; - të përshkruajë zotërimin e aftësive të gjelbra në CV; - të demonstrojë aftësitë e gjelbra gjatë intervistave të punës.
--	-------------	--

5. MODULI “NJOHJA E VETVETES DHE VENDIMMARRJA”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Njohja e vetvetes dhe vendimmarrja	
Qëllimi i modulit	Moduli synon aftësimin e pjesëmarrësve me mendësinë dhe procesin e vetëvlerësimit, hulumtimit të tregut dhe vendimmarrjes për një punësim të qëndrueshëm dhe mundësi për rritje në karrierë.	
Kohëzgjatja e modulit	8 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi kryen vetëvlerësimin. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të kryejë procesin e vetëvlerësimit; - të evidentojë nevojat, dëshirat, pasionet dhe të vendosë përparësi; - të marrë vendime sipas nevojave dhe prioriteteve. - të përshkruajë rëndësinë dhe vlerat e punës për jetesën, rritjen në karrierë, për sigurimin shëndetësor, pensionin etj.

	RN 2	Pjesëmarrësi merr vendime për karrierën e tij. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë të: - të listojë punë/profesione bazuar në nivelin e kualifikimit; - të vlerësojë nevojën për punë kohë me të plotë apo kohë të pjesshme; - të vlerësojë nevojën për punë referuar nivelit të pagës; - të marrë vendime bazuar në kushtet individuale, nivelin e kualifikimit, perspektivën e karrierës.
--	-------------	---

6. MODULI “DOKUMENTACIONI PERSONAL DHE KONTRATA E PUNËS”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Dokumentacioni personal dhe kontrata e punës	
Qëllimi i modulit	Moduli i njeh pjesëmarrësit me dokumentacionin personal dhe kontratën e punës, si dhe i aftëson për kryerjen e procedurave për plotësimin e dokumentacionit personal, shkrimin e CV-së dhe letrës së motivimit, me shkrim dhe kompjuter.	
Kohëzgjatja e modulit	8 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënës (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi përshkruan dokumentet kryesore personale. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë dokumentacionin personal dhe funksionet përkatëse (karta e identitetit, pasaporta, llojet e certifikatave etj.); - të përshkruajë përfitimet e pajisjes me këtë lloj dokumentacioni; - të përshkruajë përfitimet e pasjes së llogarisë bankare.
	RN 2	Pjesëmarrësi përdor platformën e-Albania për të siguruar dokumentacionin personal. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionin dhe përfitimet e përdorimit të portalit e-Albania; - ta përdorë portalin e-Albania nga kompjuteri, celulari, tableti; - të shkarkojë dokumentet personale përmes kësaj platforme; - të bashkëlidhë në e-mail dokumentet personale.

	RN 3	Pjesëmarrësi shkruan CV-në me shkrim dhe kompjuter. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë se çfarë është CV-ja dhe informacionet që përmban; - të hartojë një listë të punëve të mëparshme; - të hartojë një listë të aftësive të rëndësishme; - të shkruajë CV-në në kompjuter bazuar në format. - ta dërgojë CV-në me email.
	RN 4	Pjesëmarrësi shkruan letrën e motivimit me shkrim dhe kompjuter. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë përmbajtjen e letrës së motivimit; - të shkruajë letrën e motivimit sipas formatit; - të bëjë një përshkrim të përgjithshëm të arritjeve/përvojave në fushën ku është duke aplikuar; - të theksojë përvojat dhe nivelin e pozicionit që ka dhe atij që synon të arrijë; - të dërgojë letrën e motivimit me email.
	RN 5	Pjesëmarrësi përshkruan elementet e kontratës së punës. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë kontratën e punës dhe llojet e saj; - të përshkruajë lidhjen e marrëdhënieve të punës midis punëmarrësit dhe punëdhënësit; - të përshkruajë kushtet e kontratës së punës; - të përshkruajë dokumentacionin e përdorur në vendin e punës.

7. MODULI “AFTËSI PËR TË KËRKUAR PUNË

Përshkruesi i modulit	
Titulli	Aftësi për të kërkuar punë
Qëllimi i modulit	Moduli i aftëson pjesëmarrësit për të kërkuar punë përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe platformave online, si dhe për intervistën e punës.
Kohëzgjatja e modulit	12 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime)
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.

Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi kërkon punë nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të listojë kanalet e kërkimit për mundësi punësimi (familjarë, shokë të shkollës, miq etj.); - të shpërndajë informacionin te të gjithë njohurit e tij se po kërkon punë, duke kryer takime, biseda telefonike, mesazhe dhe email; - të kontaktojë drejtpërdrejt punëdhënësit për mundësi pune; - të informohet mbi panairët e punës që organizohen dhe të marrë pjesë; - të regjistrohet në Zyrën e Punësimit si “punëkërkues i papunë”.
	RN 2	Pjesëmarrësi kërkon punë nëpërmjet internetit. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të identifikojë mundësitë për aplikim për punë online; - të hartojë një listë të platformave online të punësimit; - të përdorë mediat sociale për të kërkuar dhe aplikuar për vende pune; - të vizitojë faqet e kompanive dhe të gjejë seksionin e shpalljeve për punë.
	RN 3	Pjesëmarrësi përdor platformën e-Albania. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përdorë shërbimin elektronik "aplikim për regjistrim si punëkërkues"; - të kryejë aplikimin për regjistrim si punëkërkues sipas hapave.
	RN 4	Pjesëmarrësi përdor platformën e AKPA-s për kërkimin e punës. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë funksionin dhe përfitimet e përdorimit të platformës së AKPA; - të regjistrohet si punëkërkues; - të regjistrohet për formimin profesional; - të kërkojë për vende të lira pune; - ta përdorë platformën nga kompjuteri, celulari, tableti.
	RN 5	Pjesëmarrësi demonstroi sjelljet përpara, gjatë dhe pas intervistës së punës Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të hulumtojë në lidhje me profilin e kompanisë;

		- të parashikojë pyetjet që mund t'i bëhen nga intervistuesi; - të zbatojë etikën e komunikimit gjatë intervistës; - të vishet në mënyrë të përshtatshme; - të kontaktojë me intervistuesin në kohën e përcaktuar.
--	--	---

8. MODULI “RREGULLAT E SIGURISË NË JETËN E PËRDITSHME DHE NË PUNË”

Përshkruesi i modulit		
Titulli	Rregullat e sigurisë në jetën e përditshme dhe në punë	
Qëllimi i modulit	Moduli i njeh pjesëmarrësit me elemente të sigurisë në jetën e përditshme dhe në vendin e punës, dhe i aftëson t'i menaxhojnë në të mirë të sigurisë dhe mirëqenies së tyre, në funksion të përmbushjes së detyrimeve ligjore, të përmirësimit të produktivitetit në vendin e punës etj.	
Kohëzgjatja e modulit	4 ORË MËSIMORE (Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime)	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Ky modul mund të përdoret për të gjithë pjesëmarrësit, pavarësisht grupmoshave dhe prejardhjeve. Pjesëmarrësit duhet të jenë mbi 15 vjeç dhe të kenë përfunduar të paktën arsimin fillor.	
Rezultatet e të Nxënit (RN) dhe procedurat e vlerësimit	RN 1	Pjesëmarrësi përshkruan sigurinë në jetën e përditshme. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë konceptin e sigurisë fizike në jetën e përditshme; - të përshkruajë elementet e sigurisë si konsumator (leximi i etiketave, datat e skadencës etj.); - të përshkruajë rëndësinë e çantës së ndihmës së parë; - të përshkruajë rregullat e ecjes së sigurt në rrugë si këmbësor, si përdorues i biçikletës dhe makinës; - të listojë numrat e telefonit që duhet të përdorë në raste emergjence (policia, spitali, zjarrfikësja); - të kryejë distancim social, kur është e nevojshme.
	RN 2	Pjesëmarrësi përshkruan sigurinë në vendin e punës. Kriteret e vlerësimit Pjesëmarrësi duhet të jetë i aftë: - të përshkruajë detyrimet e tij si punëmarrës, në bazë të ligjit; - të shpjegojë detyrimet që ka punëdhënësi, në bazë të ligjit; - të përshkruajë rëndësinë e përdorimit me korrektësi të pajisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës; - të përshkruajë përfitimin e mjeteve mbrojtëse në vendin e punës, si veshja, syzet e posaçme, kufjet për zhurmat etj.; - të përshkruajë elementet e rrezikut në vendin e punës, si p.sh.: substancat dhe agentët helmues, transporti i peshave të rënda, ndotja e ajrit etj.; - të përshkruajë planin e evakuimit në rast zjarri; - të përshkruajë rëndësinë e raportimit në çdo rrezik dhe incident.